



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E FINANCËS DHE PROJEKTEVE

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE NË KUADËR TË PROJEKTIT SALSTAT

Në zbatim të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe në kuadër të mbështetjes Zvicerane për Statistikat Shqiptare në nivel bashkie, e quajtur Statistika të Forta Lokale Shqiptare (SALSTAT) që është pjesë e programit “Bashki të Forta” i financuar nga Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim, Drejtoria e Financës dhe Projekteve pranë INSTAT, shpall proçedurat e rekrutimit për vendet e lira si më poshtë vijon:

1. Koordinator i Projektit SALSTAT për të Dhënat Administrative dhe Regjistrat (1 pozicion)

Objektivi i përgjithshëm i projektit SALSTAT është:

Të mbështesë INSTAT-it në ndërtimin dhe forcimin e sistemit statistikor të Shqipërisë duke siguruar një sistem statistikor të qëndrueshëm të të dhënave që është i rëndësishëm për vendin në përpjekjet e saj për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian;

Të lejojë administratat bashkiake të përmbushin funksionet dhe detyrat e tyre në një mënyrë efikase dhe efektive duke ofruar informata statistikore të besueshme;

Ngritjen e komponentëve kryesorë të regjistrave bazë për qëllime specifike administrative dhe statistikore, veçanërisht në nivel rajonal dhe lokal.

Përgjegjësitë e Koordinatorit të Projektit SALSTAT për të Dhënat Administrative dhe Regjistrat janë:

Të mbështesë në vlerësimin dhe dokumentimin e hollësishëm të të dhënave ekzistuese në burimet relevante të të dhënave (të dhënat administrative dhe regjistrat) të rëndësishëm për projektin SALSTAT;

Të mbështesë zhvillimin dhe përshkrimin e përmbajtjes së të dhënave administrative dhe regjistrave (katalogun e variablave - përkufizimet dhe listat e kodimit të variablave);

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Të mbështesë dokumentimin e të gjitha burimeve të mundshme të variablave që lidhen me projektin SALSTAT;

Të mbështesë komunikimin dhe koordinimin me partnerët përkatës të përfshirë (institucionet qeveritare kombëtare dhe lokale), veçanërisht me institucionet përgjegjëse për regjistrat ose të dhënat administrative;

Të mbështesë INSTAT-in në punën për planifikimin dhe ngritjen e bazave të të dhënave (struktura) dhe proceset e funksionimit (bazat e të dhënave, shkëmbimi i të dhënave dhe azhurnimi i të dhënave) - cikli i zbatimit;

Detyra të tjera që mund të kërkohen në mbështetje të projektit SALSTAT sa herë të jetë e nevojshme.

- ✓ Niveli i pozicionit: Me kohë të plotë
- ✓ Fillimi i punës: data 01.04.2019

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për të gjithë aplikantët do të jetë data 15/03/2019.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Kërkesë për pozicionin
- b- Jetëshkrim i aplikantit (CV, sipas formatit të europass);
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda **datës 15/03/2019** pranë Drejtorisë të Financës dhe Projekteve në INSTAT.

Kualifikime dhe Eksperienca

Diplomë Universitare të avancuar (Diplomë Masteri ose ekuivalent) në statistikë, informatikë, ekonomi apo fusha të tjera përkatëse që lidhen me statistikat.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Aftësi të tjera:

- Disa vite përvojë në fushën e statistikave, konsultimit ose IT, përvoja e punës me të dhëna administrative apo regjistra do të ishte një avantazh.
- Aftësi për të konceptuar dhe përgatitur raporte në një mënyrë të qartë, konçize dhe bindëse.
- Përvojë në menaxhim projektesh dhe në raportim.
- Aftësi të mira komunikuese me shkrim dhe me gojë për t'u angazhuar në diskutime të detajuara me ministritë dhe agjencitë dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë);
- Aftësi për të bashkëvepruar me të gjitha nivelet e institucionit (INSTAT);
- Aftësi për të strukturuar dhe priorizuar aktivitetet e punës në mënyrë të pavarur dhe për t'iu përgjigjur detyrave të shumëfishta, duke pasur një shkallë të lartë të vetë iniciativës.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042233356, ose në adresën: Instituti i Statistikave, Bulevardi: “Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017Tiranë, SHQIPËRI”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al